

AGJENCIA SHETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS

**KATALOG
I EKSPozITËS**

**DËBIMI I SHQIPTARËVE
NGA SANXHAKU I NISHIT
1877/78**

Prishtinë, 2018

AGJENCIA SHËTETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS
STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES

Botime të veçanta
Special editions

KATALOG

DËBIMI I SHQIPTARËVE NGA SANXHAKU I NISHIT
1877/78

THE EXPULSION OF ALBANIANS FROM SANJAK OF NISH
1877/78

Botues

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
State Agency of Kosovo Archives

Kryeredaktor i botimit
Ramë Manaj

Kordinator-konsulent
Jusuf Osmani

Autorë të ekspozitës
Shpresa Mekaj
Bekim Aliu

Redaktor gjuhësor
Habibe Qovanaj

Redaktor teknik
Bekim Aliu

Tirazhi
150 copë



AGJENCIA SHTETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS

MBËSHKETUR

nga

QENDRA DOKUMENTARE SHKENCORE - PRISHTINË
KËSHILLI KOMBËTAR PËR PAQË DHE INTEGRIM - PRISHTINË

KATALOG

DËBIMI I SHQIPTARËVE NGA SANXHAKU I NISHIT 1877/78

*Në 140 Vjetorin e dëbimit të shqiptarëve
nga Sanxhaku i Nishit*

Prishtinë, 2018

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës“Pjetër Bogdani”

314.151(=18:497.1)"1977/1978"

94(=18:497.1)"1977/1978"

017:930.25(496.5)

Katalog : Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877/78 = The expulsion of albanians from sanjak of Nish 1877/78. / kryeredaktor i botimit Ramë Manaj. – Prishtinë : Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2018. – 66 f. : ilustr.; 23 cm. – (Botime të veçanta)

ISBN 978-9951-404-49-5

MISIONI I AGJENCISË SHTETËRORE TË ARKIVAVE TË KOSOVËS NË PREZANTIMIN E DOKUMENTEVE ARKIVORE

Arkivat ruajnë kujtesën e popullit. Posedojnë thesar të çmuar dhe pjesë thelbësore dhe të pazëvendësueshme të pasurisë kulturore, historike dhe shkencore. Arkivat janë memorie e një populli, pra janë bazë e identiteti historik e kulturor të individëve dhe të popujve. Ndërsa, çdo dokument i shkruar, fotografi ose dokument në zë, elektronik ose në media të tjera janë dëshmi e kohës kur janë krijuar.

Dokumenti arkivor si dëshmi për rikonstruimin shkencor të së kaluarës historike ka hyrë në një fazë të re të ekzistencës, duke përjetuar një fazë të renesancës në sferën e interesit të shkencës, kulturës, politikës, ekonomisë dhe të formave të tjera të jetës publike. Interesimi për dokumente arkivore tani nuk është vetëm i shkencës së historisë, por edhe i disiplinave tjera shkencore.

Arkivat grumbullojnë, mbrojnë, ruajnë, rregullojnë, përpunojnë, publikojnë, prezantojnë dhe japin në shfrytëzim lëndën arkivore për qëllime profesionale dhe shkencore.

Roli dhe rëndësia e arkivave gjithnjë e më tepër është duke u rritur, sidomos në ditët e sotme, ku përveç dokumenteve konvencionale, në letër, janë duke u krijuar edhe dokumentet jokonvencionale, audiovizuele dhe elektronike-digjitale. Të gjitha këto e ngritin rëndësinë, rolin dhe funksionin e arkivit, i cili gjithnjë e më tepër po del nga kornizat e rolit të rojtarit pasiv të dokumenteve arkivore dhe inkuadrimin e tij në rrjedhat bashkëkohore të jetës publike, shkencore, kulturore, arsimore, etj. duke ia ofruar vlerat e tij publikut të gjerë.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës si institucion qendror shtetëror është duke kryer punën me përkushtim maksimal në shërbim të misionit të vet të ruajtjes së lëndës arkivore, sistemimit dhe trajtimit të saj duke e bërë të gatshme për të gjithë studiuesit dhe palët e interesuara me qëllim të shfrytëzimit të dokumenteve arkivore.

Një vend të veçantë në misionin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës zë edhe veprimtaria hulumtuese-shkencore, prezantimi i dokumenteve arkivore, siç janë publikimi i dokumenteve, organizimi i ekspozitave dhe të tjera.

Ekspozitat organizohen me qëllim të prezantimit të ndonjë ngjarje të caktuar historike, ose ndonjë periudhe historike, pastaj për jetën dhe veprimtarinë e ndonjë personaliteti, ndonjë institucioni.

Me rastin e shënimit të 140 Vjetorit të dëbimit të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877/78, është përgatitur ekspozita tematike, kryesisht nga burimet arkivore: dokumente, fotografi, harta etj. që ruhen në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe në arkiva të tjerë.

Për ekspozitën “Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit” është përpiluar katalogu, i cili u shërben vizitorëve si udhërrëfyes nëpër ekspozitë, ndërsa hulumtuesve dhe shfrytëzuesve të lëndës arkivore si mjet informativ për lëndën dhe temën e cila është prezantuar në ekspozitë.

Grumbullimi, përzgjedhja dhe prezantimi i eksponateve, për t' u përfshirë në ekspozitë dhe katalog, është punuar nga arkivistët profesionalistë të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Kjo ekspozitë shpalos dëshmi të dokumentuara nga shumë burime për spastrimet etnike të shqiptarëve nga trojet e tyre autoktone, nga fshatrat dhe qytetet e Sanxhaku e Nishit, duke përkujtuar edhe pasojat, të cilat jetojnë sot e kësaj dite në memorien e brezave të pasardhësve të larguar me dhunë nga ushtria serbe në vitet 1877/78.

Ndihmesë dhe përkrahje për përgatitjen e kësaj ekspozite ka dhënë edhe Qendra dokumentare shkencore dhe Këshilli Kombëtar për Paqe dhe Integrim në Prishtinë.

MA .Ramë MANAJ

MISSION OF THE STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES IN PRESENTATION OF ARCHIVAL RECORDS

Archives preserve the memory of people. They possess precious treasure and essential and indispensable parts of cultural, historical and scientific wealth. Archives are a memory of a people. They are the foundation of the historical and cultural identity of individuals and nations. Whereas, any written document, photo or audio records, electronic or other media is the evidence of the time when they are created.

Archival records as the evidence of the scientific reconstruction of the historical past has entered into a new phase of existence, experiencing a stage of the renaissance in the sphere of interest of science, culture, politics, economy and other forms of public life. Interest in the archival records is not just about history science, but also about other scientific disciplines.

Archives collect, protect, preserve, arrange, process, publish, present and makes available the archival records for professional and scientific purposes.

The role and importance of archives is increasing, especially nowadays, where apart of conventional records, on the paper, audio-visual and electronic-digital records are being created. All of these increase the importance, role and function of the archives, which is increasingly emerging from the role of the passive guardian of the archival records, and its involvement in contemporary trends in public, scientific, cultural, educational, etc. by offering its values to the wider public.

The State Agency of Kosovo Archives as a central state archival institution carries out the tasks with the utmost dedication to its mission to preserve, arrange and process the archival records and making it available to all scientists and interested parties to use the archival records.

A special part in the mission of the State Agency of Kosovo Archives is the scientific research activity, presentation of archival records such as publication of records, organization of exhibitions and others.

Exhibitions are organized for the purpose of presenting a certain historical event, or any historical period, and the life and activities of any personality, institution, etc.

On the occasion of the 140 Anniversary of the expulsion of Albanians from the Sanjak of Nis in 1877/78, thematic exhibition is prepared, mainly from archival sources: records, photographs, maps etc. stored in the State Agency of Kosovo Archives and in other archives.

For the exhibition "Expulsion of the Albanians from the Sanjak of Nis", a catalog was created, which serves the visitors as a guide to the exhibition, whilst to researchers and users of the archival records as an information tool for the subject, topics presented at the exhibition.

Collection, selection and presentation of exhibits, to be included in the exhibition and the catalog, was prepared by professional archivists of the State Agency of Kosovo Archives.

This exhibition displays evidences documented from numerous sources for the ethnic cleansing of Albanians from their autochthonous homelands, villages and towns of Sanjak and Nis, thus recalling even the consequences that are still in the memory of generations of descendants expelled from the violence exercised by the Serbian army during 1877/78.

Support and assistance for the preparation of this exhibition has also been provided by The Center for Documentary Science and the National Council for Peace and Integration in Pristina.

MA. Ramë MANAJ

DËBIMI I SHQIPTARËVE NGA SANXHAKU I NISHIT

Shqiptarët deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX jetonin në shumicën e qyteteve dhe qytezave, fshatrave të Sanxhakut të Nishit si dhe në rajonet e përafërta. Sanxhaku i Nishit ishte një njësi administrative-territoriale e Perandorisë Osmane me qendër në Nish, qytet i lashtë, qendër e Dardanisë Ilire.

Pjesa dërrmuese e familjeve shqiptare ishin përqendruar në Qarkun e Toplicës, i cili përfshinte rrethin e Jabllanicës, Kosanicës, Prokuplës dhe qytetin e Prokuplës; Qarkun e Nishit që përfshinte rrethet e Vllasotincës, Leskocit, Nishit dhe qytetin e Nishit; Qarkun e Vranjës me rrethin e Masuricës, Polanicës, Pçinjit dhe qytetin e Vranjës dhe Qarkut të Pirotit (Nishavës). Banorë shqiptarë kishte edhe në vende tjera, sidomos në qytete, si p.sh. në Qupri, Paraçin, Uzhicë, Krushec, Aleksinc, Karanovc (Kralevë) madje edhe në Beograd.

Në Sanxhakun e Nishit jetonin rreth 250.000 banorë shqiptarë autokton të vendosur në mbi 700 vendbanime vetëm me banorë shqiptarë, por edhe në të përziera ku jetonin serbë, çerkezë etj.

Që nga viti 1833 kur Serbia kishte fituar autonomi kulturore nga Perandoria Osmane, kishte filluar planet për pushtimin e tokave shqiptare. "Naçertanija" e Ilija Grashaninit ishte një platformë dhe program për dëbimin e shqiptarëve nga trojet e veta. Ky program u konstruktua në vitin 1844, ndërkohë që nisë të realizohet gjatë dhjetorit 1877 dhe janarit 1878, duke vazhduar më vonë në vitin 1912.

Pas 16 dhjetorit 1877, ushtria serbe do ta fillojë fushatën më tragjike që është zhvilluar ndonjëherë në Ballkan kundër popullsisë së pambrojtur shqiptare të Sanxhakut të Nishit. Divizionet serbe të Danubit dhe Moravës sulmojnë popullsinë civile, duke vrarë e masakruar pleq, gra, fëmijë etj. Ua vënë flakën vendbanimeve shqiptare, djegin shtëpi dhe objekte të tjera të pronarëve shqiptarë. Çdo gjë e shndërrojnë në hi e pluhur.

Serbia në këtë luftë ushtroi një spastrim masiv të popullsisë shqiptare, ku në këtë krim u mbështet edhe nga forcat ruse.

Ushtarakët serbë për të realizuar këtë qëllim kishin përdorur mjetet më brutale të dhunës fizik ndaj shqiptarëve. Me dhjetëra mijëra shqiptarë të moshave të ndryshme vriten nga zjarri i armëve, i bajonetave, nga djegiet për së gjalli, nga ngrirjet në dëborë e akull. Togje kufomash shqiptare, shtëpi të rrënuara, nëna të ngrira me foshnje në gji, fëmijë të uritur e të pambrojtur, uri e skamje nga zjarret dhe nga plaçkitjet si dhe skena të trishtueshme ishin pamjet që mbushnin Sanxhakun e Nishit, në qarqet e Nishit, Pirotit, Vranjës, Leskocit, Përkuplës, Kurshumlisë etj. Nëpër lumenjtë Moravë, Nishavë etj., notonin me qindra kufoma shqiptare të hedhura nga forcat ushtarake. Nga vrasjet e shumta u hapën varre masive, që nga Nishi e deri në Kurshumli. Princi serb Millan Obrenoviq, për të arritur këtë qëllim, ushtarëve të vet serbë u kishte shpërndarë proklamata, në të cilën thuhej: *"... sa më pak shqiptarë që të mbetën në territoret e çliruara nga Turqia, aq më shumë do të kontribuoni për shtetin. Sa më shumë shqiptarë të shpërngulur, aq më të mëdha meritat për atdhe"*.

Dhuna dhe shfarosja e shqiptarëve bëhej në mënyrat dhe metodat më mizore dhe barbare, për çka dëshmojnë edhe vetë serbët. Një mësues, dëshmitar i kohës shkruan: "... Në acar dhe të ftohtë të madh të dimrit të vitit 1877-1878 pashë njerëz duke ikur të zhveshur e të zbathur që kishin braktisur dhomat e veta të ngrohta me përplot mall.....Përgjatë rrugës Gërdelicë-Vranjë dhe deri në Kumanovë, në të dy anët e rrugës vëreheshin kufomat e fëmijëve, të pleqeve e të tjerëve që kishin vdekur nga të ftohtit. Tërheqja ka qenë tragjike, kuajt dhe qetë tërhiqnin ngadalë qerret nëpër borë sepse qerre kishte pak. Disa fëmijë të hedhur, të humbur apo gjysmë të vdekur nga lodhja dhe uria..." . Udhëpërshkruesi serb, Sreten Popoviq, ndër të tjera, shkruante: "Ato netë, shumë familje shqiptare duke udhëtuar me fëmijët e tyre, nga acari i madh pësuan humbje të mëdha në njerëz. Shumë fëmijë në qerre ose në shpinë të nënës u ngrinë dhe vdiqën. Kishte raste të shumta kur edhe pleqtë vdisnin nga të ftohtit". Në një burim tjetër thuhet: "Me ndjekjen e arnautëve, disa fshatra në ato anë mbetën plotësisht të shkreta. Disa fshatrave nuk u diheshin emrat, sepse nuk kishte kush t'i tregonte, prandaj ato fshatra të shkreta të Sanxhakut të Nishit - Prokuplë, Leskoc, Vranje duhet të popullzoheshin".

Shkrimtari serb Jovan Haxhivasileviq, shpjegon qëllimet e qeverisë serbe për pushtimin e territoreve në Jug. Ai shkruan se dëbimi i shqiptarëve u bë me qëllim "që Serbia të bëhej shtet i pastër nacional" dhe të krijohet mundësia "që aksioni serb në të ardhmen të drejtohej kah pjesët e Kosovës".

Pas dëbimit të shqiptarëve, Serbia kishte dërguar ekipe për ta popullzuar atë pjesë me kolonistë para se të mbahej Kongresi i Berlinit. Ekipet për formimin e komunave dhe regjistruesit, ndër të tjera shkruanin: "Këtu të gjitha fshatrat kanë qenë shqiptare, tani janë të shkreta, të djegura dhe të rrënuara, prandaj edhe nuk mund të formohen komuna". Mirëpo, përkundër kësaj, Serbia zyrtare filloi me nxitim kolonizimin e vendbanimeve të Sanxhakut të Nishit me elementin sllav të sjellë nga viset e ndryshme si, Serbia, Mali i Zi, Bosnja etj. Pushteti dhe kolonët e rinj serbë plaçkitën tërë pasurinë e shqiptarëve.

Në territorin e Kosovës shqiptarët muhaxhirë u vendosën në fshatra dhe qytete. Pati lëvizje të mëdha, ku nga fshatrat kaluan në qytet, ose prej një fshati në fshatin tjetër. Ata u vendosën kryesisht në trevat rreth kufirit me Serbinë e sotme, në territorin e rrafshit të Kosovës, Llapit, Anamoravës etj. me shpresë se një ditë do të kthehen në vendlindjen e tyre. Shumë familje shqiptare muhaxhire u vendosën edhe në territorin e Maqedonisë, e shumë prej tyre përfunduan jashtë Kosovës, tej Bosforit, në shkretëtirat e Anadollit e më gjerë deri në Siri. Tani është një përvjetor reflektimi për brezat që stërgjyshërit e tyre u detyruan të lënë vatrat dhe gjithë çfarë kishin para dhunës së ushtrisë së Serbisë.

E kaluara nuk duhet harruar. Krimi, vendbanimet dhe pronat e Sanxhakut të Nishit nuk do të harrohen nga shqiptarët. E drejta për pronën është një e drejtë e patjetërsueshme, ajo kurrë nuk vjetërsohet.

Prof. dr. Jusuf Osmani

EXPULSION OF THE ALBANIANS FROM THE SANJAK OF NIS

Albanians until the second half of the 19th century lived also in most of the cities, towns and villages of the Sanjak of Nis, and in the nearby regions. The Sanjak of Nis was an administrative-territorial unit of the Ottoman Empire based in Nis, the ancient city, which was the center of Illyrian Dardania.

The vast majority of Albanian families were concentrated in the District of Toplica, which included the regions of Jablanica, Kosanica, Prokupje and the town of Prokuplje, the District of Nis, which included the regions of Vlasotinca, Leskovac, Nis and the city of Nis, the District of Vranje with regions of Masurica, Polanica, Pcinj and the city of Vranje and Pirot District (Nisava). Albanian residents were also in other places, especially in cities, like Qupri, Paracin, Uzice, Krushec, Aleksinc, Karanovc (Kraljevo) and even in Belgrade.

In the Sanjak of Nis lived about 250,000 Albanian autochthonous residents settled in over 700 settlements with solely Albanian residents, but also in the mixed ones where Serbs, Circassians and the others lived.

Since 1833 when Serbia had earned cultural autonomy from the Ottoman Empire, it had begun plans for the conquest of Albanian lands. Ilija Grashanin's "Načertanija" was a platform and a program for the expulsion of the Albanians from their homelands. This program was constructed in 1844, whilst its implementation began during December 1877 and January 1878, to be continued later in 1912.

After 16 December 1877, the Serbian army started the most tragic campaign ever conducted in the Balkans area against the defenseless Albanian population of Sanjak of Nis. The Serbian divisions of the Danube and Morava attacked the civilian population, killing and massacring elders, women, children and others. They set fire to Albanian settlements, burned houses and other objects of the Albanian owners. Everything had been turned into dust and ashes. Serbia in this war had exercised a massive ethnic cleansing of the Albanian population, and in this crime had been supported by Russian forces. The Serbian soldiers, to accomplish this goal had used the most brutal means of physical violence against Albanians. Tens of thousands of Albanians of different ages were killed by firearms, bayonets, live burned, freezing in the snow and ice. Lots of Albanian corpses, ruined houses, frozen mothers having their babies in their breast, hungry children, unprotected, hunger and famine from the fires and robberies and these miserable scenes were the sights that covered the Sanjak of Nis, in the districts of Nis, Pirot, Vranje, Leskovac, Prokuplje, Kurshumlia, etc. Hundreds of Albanian corpses sailed along the Morava and Nisava rivers thrown by the military. From Nis to Kurshumlia mass graves were opened for numerous murders. Serbian prince Milan Obrenovic, in order to achieve this goal, had distributed to his Serbian soldiers a proclamation saying: "... the fewer Albanians left in the territories liberated from Turkey, the more you contribute to the state. The more displaced Albanians, the greater merits for your country. "

Violence and the extermination of Albanians was conducted in the most cruel and barbaric means and methods, for which Serbs themselves affirm it. A teacher, a witness of the time writes: "... In the great frost and cold of the winter of 1877-1878 I saw people fleeing naked and barefoot who had abandoned their warm rooms with great melancholy.... All the way through Gërdelic-Vranje to Kumanovo, on both sides of the street, the bodies of children, elders and others who had died from the cold could be seen. The withdrawal had been terrible, horses and oxen slowly pulled the chariots in the snow, because there were few chariots. Some children that were thrown, lost or half dead by fatigue and hunger ... "The Serbian storywriter, Sreten Popovic, among other things, wrote: "Those nights, many Albanian families traveling with their children, suffered huge losses in humans from the great frost. Many children in the chariots or on their mother's back were frozen and died. There were many cases when even elders died from the cold. "In another source, it says: "By pursuing of the Arnauts (Albanians), some villages on that area had remained completely abandoned. In some cases the names of some villages were not known because there was no one to tell, so those abandoned villages of Sanjak of Nis - Prokuple, Leskovac and Vranje had to be inhabited. " Serbian writer Jovan Hadzivasilevic explains the Serbian government's intentions of invading territories in the South. He writes that the expulsion of Albanians was intended to "make Serbia a pure nation state" and to create the possibility "that the Serbian actions in the future be directed towards parts of Kosovo".

After the expulsion of the Albanians, Serbia had sent teams to inhabit that part with colonists before the Berlin Congress. The teams for establishing municipalities and the enumerators among other things, wrote: "Here all the villages were Albanian villages, now they are abandoned, burnt and ruined, therefore no municipality can be established." However, in spite of this, the official Serbia hastily began the colonization of the settlements of Sandjak of Nis with the Slavic element brought by different areas like Serbia, Montenegro, Bosnia etc. The government and the new Serbian colonists plundered all the wealth of the Albanians.

Muhajir Albanians were settled in the villages and towns in the territory of Kosovo. There were many relocations of people who migrated from villages to towns, or from one village to the other village. They were settled mostly in the areas neighboring the border of today's Serbia, in the territory of Kosovo Plane, Llap, Anamorava, etc. with the hope that one day they will return to their hometown. Many muhajir Albanian families also settled in the territory of Macedonia, and many of them ended outside Kosovo, beyond the Bosphorus, in the deserts of Anatolia and even beyond up to Syria. Now it is an anniversary of reflection for generations that their forefathers were forced to flee their homes and all they had from the violence exercised by the Serbian army.

The past should not be forgotten. The crimes and settlements and also the properties of the Sanjak of Nis, will not be forgotten by Albanians. Property right is an absolute right, it never becomes obsolete.

Prof. Dr. Jusuf Osmani

ETHNOGRAPHISCHE ÜBERSICHT DES EUROPÄISCHEN ORIENTS

zusammengestellt von H. KIEPERT, Berlin im Mai 1915.



**VENDBANIMET NË SANXHAKUN E NISHIT KU KA JETUAR
POPULLATA SHQIPTARE DERI NË VITIN 1877/1878**

- **ALABANA** (rrethina e Bllacës).
- **ALAKINCI** (rrethina e Surdulicës).
- **ARAQA** (qarku i Toplicës).
- **ARBANASHKA** (rrethina e Prokuplës). Kishte 38 shtëpi shqiptare dhe 20 serbe.
- **ARBANASI** (rrethina e Meroshinës)..
- **ARBANISHTA** (Shënoi – Dr. Sabit Uka).
- **BABOTINCI** (rrethina e Prokuplës, 7 shtëpi shqiptare, 12 shtëpi serbe).
- **BACA** (rrethina e Prokuplës). Kishte 39 shtëpi shqiptare.
- **BACIJEVICI** (rrethina e Surdulicës).
- **BADNJAVCI** (rrethina e Zhitoxhës), kishte 2 shtëpi serbe dhe 32 shtëpi shqiptare).
- **BADARXHITË** (të ardhur nga Ivaja, sot janë Zborc të Shtimës).
- **BAGAROJA** (Qarku i Toplicës).
- **BAGJURI** (Qarku i Toplicës).
- **BAJCINCI** (rrethina e Prokuplës). Kishte 51 shtëpi shqiptare.
- **BAJCINOVC** (rrethina e Prokuplës).
- **BAJKALLOLET** (të ardhur nga njëra prej vendbanimeve të quajtur Banjë.
- **BAJRA** (Qarku i Vranjës).
- **BAJRE** (rrethina e Leskovcit).
- **BELLANOVCE** (rrethina e Vlladigihanit, rrethi i Polanicës).
- **BALINOVC** (rrethina e Prokuplës).
- **BALINOVC** (rrethina e Vranjës).
- **BALINOVC I EP.** (Qarku i Vranjës, Polanicë).
- **BALINOVC I P.** (Qarku i Vranjës, Rrethi i Polanicës).
- **BALLAJINCI** (rrethina e Zhitoxhës). Kishte 47 shtëpi serbe e 6 shqiptare).
- **BALLTIQI** (Qarku i Toplicës, rrethi i Prokuplës).
- **BANJA** – Banjës-kollët (nga Banja e Kushumlisë).
- **BANJA** (Qarku i Toplicës).
- **BANJA E REPANJES.** (E shënon dr. Sabit Uka).
- **BANJA KUMAREVA** (rrethina e Vranjës).
- **BANJSKA** (rrethi i Kosanicës).
- **BANKOVIQI** (rrethi i Kosanicës).
- **BANUSHEVCI** (rrethina e Vranjës),
- **BACIQE** (Qarku i Toplicës).
- **BARA** (Qarku i Vranjës, rrethi i Masuricës).
- **BARBATOVC** (rrethina e Bllacës). Kishte 17 shtëpi shqiptare.
- **BARDUSI** (Qarku i Toplicës, rrethina e Kushumlisë). Kishte 16 shtëpi shqiptare.
- **BARLLOVA** (rrethina e Kushumlisë).
- **BEDILA** (Qarku i Toplicës, rrethi i Dobriqit).
- **BEJASHTICA E EPËRME** (rrethina e Prokuplës),
- **BEJASHTICA E POSHTME** (rrethina e Prokuplës). Kishte 14 shtëpi shqiptare.
- **BELANICA.** (Nuk kemi mundur të konstatojmë se ku gjendet ky vendbanim).
- **BELIBREGU** (Nuk kemi mundur të konstatojmë se ku gjendet ky vendbanim).
- **BELLA PALLANKA** (sot qendër komunale në Serbi).
- **BELLO** (Rrethi i Kosanicës).
- **BELLOGOSHI** (rrethina e Prokuplës).
- **BELLOLINI** (rrethina e Prokuplës) – Bollainët.
- **BELLOPOLJA** (rrethina e Kushumlisë).
- **BELOTINAC** (rrethina e Dolevcit).
- **BERAXHIKA** (Qarku i Toplicës).
- **BERIANA** (Qarku i Toplicës, më vonë Qarku i Vranjës, rrethi i Leskovcit).

- **BERILA** (rrethina e Prokuplës, 12 shtëpi shqiptare).
- **BERJANI** (Pusta Rekë).
- **BERNJASHA** (??) – Bernjashët.
- **BESELICA** (Qarku i Toplicës). Kishte shtëpi shqiptare 40 (st. turke), 20 (st. serbe).
- **BËRNICA**, shtëpi shqiptare 36, shtëpi serbe 10.
- **BINXHOLLI** (??).
- **BLLACA** (Rrethi i Prokuplës). Kishte 35 shtëpi shqiptare.
- **BOBIŠHTE** (rrethina e Leskovcit)?
- **BODERLAKET** (nuk dihet nga janë).
- **BOGOJEVCI** (rrethina e Leskovcit).
- **BOGUJEVCI I EP.** (rrethina e Prokuplës). Kishte 8 shtëpi shqiptare.
- **BOGUJEVCI I P.** (rrethina e Prokuplës). Kishte 16 shtëpi shqiptare).
- **BOGUNOVCI** (komuna e Medvexhës).
- **BOJNIKU** (rrethina i Leskovcit).
- **BOKA** (Qarku i Vranjës, rrethi i Pqinjtit).
- **BORINCI** (rrethina e Bojnikut).
- **BOROVCI** (rrethina e Medvexhës).
- **BOZHURNA** (rrethina e Prokuplës). Kishte 13 shtëpi shqiptare.
- **BOZHURNJA** (Qarku i Toplicës, rrethi i Dobriqit).
- **BRADASHI** (Qarku i Toplicës).
- **BRAINA** (rrethina e Medvexhës, rrethi i Jabllanicës).
- **BRASHORI** (rrethi i Jabllanicës).
- **BRALLEVA** (rrethi i Kosanicës).
- **BREGOVINA** (rrethina e Prokuplës).
- **BRENICA** (rrethina e Nishit).
- **BRENCIOI** (rrethina e Prokuplës). Kishte 40 shtëpi shqiptare).
- **BRESTI** (rrethina e Zhitoxhës). Vendbanim shqiptarë.
- **BRESTOVCI** (rrethina e Bojnikut).
- **BRESTVOCI** (rrethina e Leskovcit).
- **BREZNICA E EP.** (rrethina e Prokuplës). Kishte 2 shtëpi shqiptare dhe 8 serbe).
- **BREZNICA E P.** (rrethina e Prokuplës). Kishte 31 shtëpi shqiptare.
- **BREZNIKU** (Qarku i Toplicës, rrethina e Prokuplës).
- **BUBLICA** (rrethina e Prokuplës).
- **BUCINCA** (rrethina e Prokuplës).
- **BUÇINCI** (Rrethi i Prokuplës). Vendbanim shqiptarë.
- **BUÇIOI** (rrethina e Meroshinës). Kishte 17 shtëpi shqiptare,
- **BUĐEĆI** – Budecët.
- **BUJAK**, kishte shtëpi shqiptare 26.
- **BUJNOVCI** - Bujnocët.
- **BUKOLLORANA** (rrethina e Prokuplës). Vendbanim shqiptarë.
- **BUKOVAGLLAVA** (rrethina e Leskovcit).
- **BULLATOVCI** (rrethina e Prokuplës). Kishte 13 shtëpi shqiptare.
- **BUNBEREKU** (Rrethi i Prokuplës).
- **BUNJACI** (Rrethi i Kosanicës).
- **BURINCI** (Rrethi i Kosanicës).
- **BUSHTRANI** (rrethina e Vranjës).
- **BUYCA** (Rrethi i Jabllanicës, tani komuna e Lebanës).
- **BYOMETI I EPËRM** (rrethina e Medvexhës).
- **BYOMETI I MESEM** (rrethina e Medvexhës).
- **BYOMETI I POSHTËM** (rrethina e Medvexhës).
- **ÇEKAVICA** (rrethina e Lebanës).
- **ÇËRKVICA** (rrethina e Bojnikut).
- **ÇERNATOVA** – e Epërme dhe e Poshtme (rrethina e Zhitoxhës).
- **ÇËRNCAVCI I EPËRM** (rrethina e Leskovcit).
- **ÇËRNCAVCI I POSHTËM** (rrethina e Leskovcit).
- **ÇËRNI LLUG** (rrethina e Vranjës).
- **CERNOVERHI** (rrethina e Medvexhës, Rrethi i Jabllanicës).
- **CEROVICA** (Qarku i Toplicës, rrethi i Prokuplës).
- **CERVADIKU** (rrethi i Jabllanicës).
- **CERVONEKU?** (rrethi i Pqinjtit).

- **ÇESTELINI** (rrethina e Vranjës) – Çestelinët.
- **ÇOKOT** (rrethina e Nishit) – Çokotët - Çokotanët.
- **ÇOKOTIN** (rrethina e Medvexhës)
- **ÇUKOVÇ** (rrethina e Prokuplës).
- **ÇUKOVCI** (rrethina e Bojnikut, Rrethi i Jabllanicës) – Çukofcët.
- **ÇUKOVCI** (rrethina e Leskovcit).
- **ÇESTELINI** (rrethina e Vranjës).
- **ÇOKOT** (rrethina e Nishit).
- **ÇOKOTIN** (rrethina e Medvexhës)
- **CUBOLLËT** (Janë nga Toplica, por nuk dihet se të cilit fshat).
- **ÇUKOVÇ** (rrethina e Prokuplës).
- **ÇUKOVCI** (rrethina e Bojnikut, Rrethi i Jabllanicës).
- **ÇUKOVCI** (rrethina e Leskovcit).
- **ÇVIRCA** – rrethina e Medvexhës - (në vitit 1878 është ndarë në dy pjesë).
- **DABINOVI** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 22 shtëpi shqiptare.
- **DAMACËT** (nuk dihet se nga kanë ardhur).
- **DANKOVËT** (rrethina e Kushumlisë) - Dankët (Kelani). Kishte 26 shtëpi shqiptare.
- **DAVIDOVCI** (rrethina e Vranjës).
- **DEDINCA** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 36 shtëpi shqiptare.
- **DEDIQI** (rrethi i Jabllanicës).
- **DEGERMANI** (rrethina e Kushumlisë).
- **DEKUTINCI** (Qarku i Vranjës, rrethi i Masuricës).
- **DËRVODELI** (rrethina e Lebanës).
- **DËRVODELJA** (Rrethina e Leskovcit).
- **DESHISHKA** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 25 shtëpi shqiptare.
- **DESHULLOVA** (rrethina e Meroshinës).
- **DEVÇA** (rrethina e Meroshinës).
- **DEVÇA E POSHTME** (Qarku i Toplicës, rrethi i Dobriqit).
- **DEVOTINI** (E regjistron dr. S. Uka).
- **DIBRA** (Nga Dibra kishte shkuar në Toplicë dhe nga aty në Marinë të Skënderaj).
- **DLLUGOJNICA** (rrethi i Masuricës).
- **DOBËRNJAC** (Qarku i Vranjës, Polanicë).
- **DOBRATIOI** (rrethina e Prokuplës). Vendbanim shqiptarë.
- **DOBRATINI** (Qarku i Toplicës). Kishte 29 shtëpi shqiptare
- **DOBRIQI** (Qarku i Toplicës, rrethi i Dobriqit).
- **DOLEVCI** (sot qendër komunale në Serbi).
- **DOPLANE** (rrethina e Leskovcit).
- **DOSHLAKËT** (nga Qarku i Toplicës, nuk dihet fshati).
- **DRAGIDEO** (rrethina e Prokuplës) – Dragidellët.
- **DRAGOBUZHDA** (rrethina e Vranjës).
- **DRAGOLLOMËT**: Janë vendosur në fshatin Dubovc të komunës së Vushtrrisë.
- **DRAGOLLUKËT** (nuk dihet se nga kanë ardhur).
- **DRAGOVCI** (rrethina e Bojnikut).
- **DRAGUSHA E EP.** (rrethina e Bllacës). Kishte 75 shtëpi shqiptare.
- **DRAGUSHA E P.** (rrethina e Bllacës).
- **DRAGUSHA E VOGËL** (rrethina e Bllacës). Kishte 64 shtëpi shqiptare.
- **DRAJINCA** (rrethina e Surdulicës).
- **DRENOVCI** – i Epërm dhe i Poshtëm (rrethina e Zhitoraxhës).
- **DRENOVCI** (rrethina e Prokuplës).
- **DRENOVCI** (rrethina e Vranjës).
- **DREVINJA** (rrethi i Prokuplës). Kishte 31 shtëpi shqiptare.
- **DUBLINCI** (rrethi i Prokuplës). Vendbanim shqiptarë.
- **DUBNICA** (rrethina e Vranjës).
- **DUBOVA** (rrethina e Zhitoraxhës).
- **DUBRANJA** (Qarku i Toplicës).
- **DUBRAVA** (rrethina e Bojnikut).
- **DUBRAVA** (rrethina e Kurshumlisë).
- **DUDOLLËT** (nuk dihet se nga kanë ardhur).
- **DUGI DOLLI** (Qarku i Nishit).

- **DUGI DOLLI** (rrethi i Kosanicës).
- **DUGOLLUKA** (rrethi i Kosanicës).
- **DUKATI** (Qarku i Toplicës).
- **DUPOLEVA** (rrethina e Vranjës).
- **GABROVAC** (rrethi i Prokuplës). Vendbanim shqiptarë.
- **GAGINCA** (rrethina e Leskovcit).
- **GAJTONI I EPËRM** (rrethina e Medvexhës).
- **GAJTONI I POSHTËM** (rrethina e Medvexhës).
- **GALLAP**. Kishte 42 shtëpi shqiptare.
- **GAZDARA** (rrethina e Medvexhës).
- **GAZDARA** (rrethi i Prokuplës).
- **GECËT** (nuk dihet se ku gjendet, ose është lagje e ndonjë fshati tjetër).
- **GËGLA** (rrethina e Lebanës).
- **GËRBAVCI** (rrethina e Medvexhës).
- **GËRBAVNICA** (rrethi i Jabllanicës). Kishte 32 shtëpi shqiptare.
- **GËRGURI I EPËRM** (rrethina e Bllacës).
- **GËRGURI I POSHTËM** (rrethina e Bllacës) – Gërgurët, shtëpi shqiptare 83.
- **GËRGUROVCI** (rrethina e Lebanit).
- **GESOLICA** (rrethi i Kosanicës).
- **GJAKA** (rrethina e Kushumlisë).
- **GJAKA E EPËRME** (Qarku i Toplicës).
- **GJAKA E POSHTME** (Qarku i Toplicës). Kishte 41 shtëpi shqiptare.
- **GJAKUS** (rrethina e Zhtoraxhës). Kishte 27 shtëpi serbe dhe 2 shqiptare.
- **GJEMNICA** - Gjepnica (rrethina e Bllacës). Kishte 7 shtëpi shqiptare).
- **GJERAKU** (Qarku i Toplicës).
- **GJEREKARJA** (Qarku i Toplicës).
- **GJINGJUSHA** (rrethina e Bojnikut).
- **GJORËT** (nuk dihet se nga kanë ardhur).
- **GJUKELLA** (rrethi i Prokuplës).
- **GJULEKARI** (rrethina e Medvexhës).
- **GJUREVCI** (rrethina e Prokuplës).
- **GJUREVCI** (rrethina e Bllacës). Kishte 12 serbe e 3 shqiptare.
- **GJURGJEVICA** (Qarku i Toplicës).
- **GJUSHILLOFCËT** (Qarku i Toplicës).
- **GJUSHINCA** (rrethina e Prokuplës). Kishte 31 shtëpi shqiptare).
- **GLLACOLLET** (nuk dihet nga kanë ardhur në Batllavë).
- **GLLASOVIKU** (rrethina e Prokuplës). Vendbanim shqiptarë.
- **GLLOBQDERËT**. (Nuk dihet se nga kanë ardhur).
- **GLLOGËT**: (nuk është konstatuar se ku gjendet fshati Glllog).
- **GOJNOVCI** (rrethina e Prokuplës). Kishte 30 shtëpi shqiptare.
- **GOLLAKU** – Gollakët.
- **GOSTURANËT** (e konsiderojnë veten muhaxhirë, por nuk dihet se nga janë).
- **GORINA** (rrethina e Leskovcit).
- **GOVORI** – Govorët.
- **GRABANICA** (Qarku i Toplicës).
- **GRABOVCI** (rrethina e Prokuplës).
- **GRABOVCI** (rrethi i Jabllanicës).
- **GRACOLLET** (nuk dihet fshati).
- **GRADNI?** (Gradishte - rrethina e Meroshinës).
- **GRAINCA** (rrethina e Bojnikut).
- **GRANICA** (Qarku i Toplicës).
- **GRASHTICËT** (nuk kemi shënime për ta).
- **GREBONICA** (rrethina e Kushumlisë, Rrethi i Kosanicës).
- **GUBETINI** (rrethina e Prokuplës). Kishte 36 shtëpi shqiptare.
- **GUBETINI** (Qarku i Toplicës, rrethi i Dobriqit).
- **GURIVCI** (rrethi i Kosanicës).
- **HASANOVCI** (rrethina e Zhtoraxhës). Vendbanim shqiptarë).
- **HËRREGAJA** (rrethina e Prokuplës). Kishte 54 shtëpi shqiptare.
- **HUMI** (Qarku i Nishit).
- **HURUGLICA E EPËRME** (rrethina e Leskovcit).
- **HURUGLICA E POSHTME** (rrethina e Leskovcit).

- **IGRISHTA** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 23 shtëpi shqiptare.
- **IGRISHTA** (rrethina e Leskocit).
- **IVAJA** (rrethina e Bojnikut, rrethi i Jabllanicës).
- **IVANKULLA**. Kishte 25 shtëpi shqiptare.
- **IZUMNO** (rrethina e Vranjës).
- **JABUÇA** (rrethina e Prokuplës). Vendbanim shqiptarë.
- **JAKOVCI** (Qarku i Vranjës, rrethi i Polanicës).
- **JASHANICA E EP.** (rrethina e Bllacës). Kishte 70 shtëpi shqiptare.
- **JASHANICA E P.** (rrethina e Bllacës). Kishte 16 shtëpi shqiptare.
- **JELLASHNICA** (rrethina e Leskocit).
- **JELLASHNICA** (rrethina e Surdulicës).
- **JELLSHNICA** (rrethina e Nishit).
- **KACABAOI** (rrethina e Bojnikut).
- **KACAPOR** (rrethina e Bllacës).
- **KACAPUNA** (Qarku i Vranjës, rrethi i Polanicës).
- **KACMERI** – Novosella (Qarku i Toplicës).
- **KALIMANCA** (rrethi i Polanicës).
- **KALLUDRA** (rrethina e Prokuplës).
- **KALLUGJERICA** (rrethina e Leskocit).
- **KAMENICA** (rrethina e Bojnikut, rrethi i Jabllanicës).
- **KAMENICA** (rrethina e Nishit).
- **KAMENICA** (rrethi i Kosanicës).
- **KAPITI** (rrethina e Medvexhës).
- **KARANOVCE** (Janë nga Kraleva që është quajtur Karanovc).
- **KASTRATI** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 31 shtëpi shqiptare.
- **KATIOI** (rrethi i Prokuplës).
- **KATUNI** (rrethina e Vranjës).
- **KËRCMARA E EP.** (rrethina e Kushumlisë).
- **KËRCMARA E P.** (rrethina e Kushumlisë).
- **KËRCMARI** (Qarku i Toplicës). Kishte 30 shtëpi shqiptare).
- **KËRTOKU** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 36 shtëpi shqiptare.
- **KIJEVAC** (rrethina e Surdulicës).
- **KITMERËT** (nga Nishi, në Prizren).
- **KLAIQI** (rrethina e Lebanës).
- **KLISIRA** (rrethina e Surdulicës).
- **KLISURA** (rrethina e Dolevcit).
- **KLISURICA** (rrethina e Prokuplës). Kishte 51 shtëpi shqiptare dhe 11 shtëpi serbe).
- **KLLASHNICA** (rrethina e Vranjës).
- **KNEZ SELLO** (Qarku i Nishit).
- **KODRA** (Qarku i Toplicës, e shënon dr. S. Uka) – Kodralitë.
- **KALLUDRA** (rrethi i Kosanicës). Kishte 26 shtëpi shqiptare.
- **KOMRENA E EPËRME** (komuna e Nishit?).
- **KONÇIQI** (rrethina e Prokuplës). Kishte 47 shtëpi shqiptare dhe 2 serbe.
- **KONJINA** (Qarku i Toplicës).
- **KONJUFÇE EPËRME** (rrethina e Bojnikut).
- **KONJUFÇA E POSHTME** (rrethina e Bojnikut),
- **KONJUHI** (Qarku i Toplicës). Kishte 41 shtëpi shqiptare.
- **KONJUSHA** (rrethina e Prokuplës). Kishte 25 shtëpi shqiptare.
- **KONJUSHA E EP.** (rrethina e Prokuplës). Kishte 15 shtëpi shqiptare.
- **KONJUSHA E P.** (rrethina e Prokuplës). Kishte 16 shtëpi shqiptare.
- **KONJUVA** (rrethina e Kushumlisë).
- **KONXHELI** (rrethina e Prokuplës). Kishte 5 shtëpi shqiptare dhe 15 serbe).
- **KOPRANI** (rrethi i Jabllanicës).
- **KORBEVCI** (rrethi i Jabllanicës).
- **KORDINCA E P.** (rrethina e Prokuplës). Kishte 13 shtëpi shqiptare.
- **KORDINICA E EP.** (rrethina e Prokuplës). Kishte 19 shtëpi shqiptare.
- **KOSHAREVA.** (E shënon dr. Sabit Uka).
- **KOSTANICA** (Qarku i Toplicës).
- **KOSTENICA** (rrethina e Prokuplës). Kishte 26 shtëpi shqiptare dhe 24 serbe).
- **KOSTRAQËT** (nuk kam të dhëna se nga kanë ardhur).

- **KOVANLLUKU** (rrethina e Meroshinës).
- **KOZHINCA** (rrethina e Prokoplës). Vendbanim shqiptar.
- **KOZMAQA** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 31 shtëpi shqiptare.
- **KOZNICA** (rrethi i Masuricës).
- **KRALANËT** (të shpërngulur nga Kralani i Dushkajës në trevën e Toplicës dhe nga aty më 1878 në fshatin Vërboc të Drenasit).
- **KREMENATA** (rrethina e Leskocit).
- **KRIVA FEJA** (rrethina e Vranjës).
- **KRIVAOA** (rrethina e Lebanit, rrethi i Jabllanicës)
- **KRIVODËRVA** (rrethi i Jabllanicës).
- **KRUSHEVICA** (rrethina e Prokoplës). Vendbanim shqiptarë.
- **KUCI** (rrethi i Kosanicës).
- **KULLA** (rrethi i Kosanicës).
- **KULLAOI** (rrethi i Jabllanicës).
- **KUMAREVA** (rrethina e Vranjës).
- **KUPILLA** (rrethi i Kosanicës).
- **KUPINA** (rrethina e Leskovcit).
- **KUPINOVA** (rrethina e Kushumlisë).
- **KURILLI** (rrethi i Prokoplës).
- **KUSHUMLIJA**. Qendër rajonale. Kishte 172 shtëpi shqiptare.
- **KUTLESHI** (rrethina e Leskovcit).
- **KUTLLATI** (rrethi i Kosanicës).
- **KUTLLOVCI I MADH** (rrethina e Bllacës).
- **KUTLLOVCI I VOGËL** (rrethina e Bllacës). Kishte 35 shtëpi shqiptare.
- **LALINCE** (rrethina e Vranjes).
- **LALINOVCI** (rrethina e Lebanës).
- **LEBANA** (Qendër komunale, në rrethin e Jabllanicës)
- **LEBOVCI** (Qarku i Vranjës).
- **LECE** (rrethina e Medvexhës, rrethi i Jabllanicës).
- **LENJANËT** (Në fshatin Karaçevë e Poshtme, komuna e Kamenicës, thuhet se janë muhaxhirë).
- **LËNMAQA**. (Nuk kemi mundur ta ubifikojmë).
- **LEPAJA** (rrethina e Meroshinës).
- **LEPOSHTICA** (rrethi i Jabllanicës).
- **LEPOSHTICA** (rrethi i Prokoplës).
- **LESKOVA** (rrethi i Masuricës).
- **LESKOVCI** (Qendër rajonale).
- **LEVOA E EPËRME** (Qarku i Toplicës).
- **LIPOVICA** (rrethina e Lebanës).
- **LIPOVICA** (rrethina e Leskovcit).
- **LITENËT**: Kanë jetuar në Pakashiticë të Ep. të Podujevës, të shpërngulur në Turqi.
- **LLAGATINCA** (rrethi i Jabllancës).
- **LLALINCA** (Qarku i Nishit).
- **LLALLOSHËT** (Në Hërriticë ë Podujevës, thuhet se janë muhaxhirë).
- **LLAPASHTICA e EP.** (rrethina e Medvexhës).
- **LLAPASHTICA E P.** (rrethina e Medvexhës).
- **LLAPATINCA** (rrethina e Bojnikut).
- **LLAZALA** (rrethina e Leskocit).
- **LLOMNICA** (rrethi i Kosanicës).
- **LLOMNICA E EPËRME** (komuna e Vllasotincës).
- **LLOMNICA E POSHTME** (komuna e Vllasotincës).
- **LLOPOTOKU** (Nuk është konstatuar se ku gjendet).
- **LLOZANA** (rrethina e Bojnikut).
- **LLOZNA** (rrethi i Kosanicës).
- **LLUGARI** (rrethina e Lebanës).
- **LLUGIOI** (rrethi i Kosanicës). Kishte 22 shtëpi shqiptare.
- **LLUKOVA** (rrethina e Kushumlisë).
- **LLUKOVA** (rrethina e Vranjës).
- **LUKOMIRI** (rrethina e Zhitoxhës). Kishte 32 shtëpi serbe dhe 4 shtëpi shqiptare).
- **LUSHA** (rrethina e Kushumlisë) – Lushakët. Kishte 29 shtëpi shqiptare.
- **MAÇKOVCI** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 38 shtëpi shqiptare.

- **MAÇKOVCI** (Qarku i Toplicës). Kishte 15 shtëpi shqiptare.
- **MAGASHI** (rrethina e Bojnikut).
- **MAGOVO** (rrethina e Kushumlisë).
- **MAJKOVCI** (rrethina e Bojnikut).
- **MALOKËT**, (nga Toplica). Nuk dihet se nga cili fshat.
- **MALQA** (rrethina e Nishit).
- **MANASTIRI** (rrethi i Prokuplës).
- **MANASTIRI** (rrethina e Nishit).
- **MAQEDONCI** (rrethina e Medvexhës).
- **MAQINA E EP.** (rrethina e Prokuplës). Vendbanim shqiptar.
- **MAQJASTENA** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 12 shtëpi shqiptare 32.
- **MAQKOVCI** (rrethina e Vranjës).
- **MARDOËT** (e ardhur nga Perpori te Braina).
- **MARINAKUTINA** (Qarku i Nishit).
- **MARKOVICE** (rrethina e Kushumlisë).
- **MAROVCI**, (rrethina e Medvexhës).
- **MARTELET** (Në fshatin Prapashiticë të Prishtinës dhe Brainë të Gallapit, janë marrë të dhënat për këta banorë).
- **MASURICA** (rrethina e Surdulicës).
- **MATAROËA** (rrethina e Kushumlisë).
- **MAVRIQËT** (të ardhur nga Medvexha).
- **MAXHARA** (rrethina e Prokuplës). Kishte 21 shtëpi shqiptare.
- **MAZARAQI** (rrethi i Polanicës).
- **MEDVECI** (rrethina e Medvexhës).
- **MEDVEXHA** (rrethi i Jabllanicës). Qohen edhe Plepollët.
- **MEGJA** (rrethina e e Leskocit). Kishte 26 shtëpi shqiptare dhe 15 shtëpi serbe.
- **MEGJUROVA E EPËRME** (rrethina e Nishit).
- **MEGJUROVA E POSHTME** (rrethina e Nishit).
- **MEHANJA** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 35 shtëpi shqiptare.
- **MEKISHI** (rrethina e Dolevcit). Kishte 30 shtëpi serbe dhe 1 shqiptare.
- **MELOVA** (rrethina e Leskocit).
- **MERKONJA** (rrethina e Medvexhës).
- **MERLAKU** (rrethina e Prokuplës).
- **MERLINCA** (Qarku i Toplicës).
- **MEROVCI** - Omerovci (rrethina e Prokuplës) Kishte 42 shtëpi shqiptare.
- **MEROEZI** (rrethina e Leskocit).
- **MERRNICA** (Qarku i Toplicës).
- **MERSHELI** (rrethina e Prokuplës).
- **MERVESHI** (rrethina e Bojnikut).
- **MËSHICA** (rrethina e Leskocit).
- **METEJEVCI I EPËRM**, (Qarku i Nishit).
- **METEJEVCI I POSHTEM** (Qarku i Nishit).
- **MEXHU-HANA** (rrethina e Bllacës) Kishte 41 shtëpi shqiptare).
- **MIHALICA** (rrethi i Jabllanicës).
- **MIHOVC** (rrethina e Leskocit).
- **MIKULANI I EPËRM** (rrethina e Kushumlisë).
- **MIKULANI I P.** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 27 shtëpi shqiptare dhe 9 serbe.
- **MIKULLOVCI** (rrethina e Prokuplës). Kishte 41 shtëpi shqiptare dhe 16 serbe.
- **MILIVOJCI** (rrethina e Vranjës).
- **MILLOVOJLOVCET** (rrethina e Leskocit).
- **MIRNICA** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 32 shtëpi shqiptare.
- **MIROQICA** (rrethi i Kosanicës).
- **MIROSLAVI**. (Nuk kam mundur të ubifikoj si vendbanim).
- **MIROVCI** (rrethi i Kosanicës).
- **MISKIQI** (rrethi i Jabllanicës).
- **MLINAKËT** (Qarku i Toplicës).
- **MLINËT**: (nga Qarku i Toplicës). Migruan në Turqi.
- **MLLADOŠHEVA** (Qarku i Toplicës).
- **MOLLIQËT** - Mollkuqët (nuk dihet se nga kanë ardhur. Një kohë të shkurtër kanë jetuar në Slatinë të Fushë-Kosovës, por janë shpërngulur.

- **MOLLOVA:** Mollovit?
- **MOMOILLI** (rrethina e Zhitoraxhës).
- **MORINET** (nga rrethina e Prokuplës).
- **MOSHANICA** (rrethina e Vranjës).
- **MRAMORI** (rrethina e Meroshinës).
- **MUCAKA** (lagje e fshatit Llallincës, e Qarkut të Vranjës).
- **MULIQ** (trevë e Toplicës. Kishte 14 shtëpi shqiptare).
- **MULEVIQ** (rrethi i Kosanicës).
- **MURIQI** - Muriqët. Konsiderohen si muhaxhirë. Kanë jetuar në Pejë dhe në fshatin Pjetërqi i Ep. i Klinës.
- **MUZACI** (rrethina e Bllacës). Kishte 42 shtëpi shqiptare.
- **NEGOŠAVLE** (rrethina e Medvexhës).
- **NELAKU** (rrethina e Leskocit).
- **NERADOVCI I EPËRM** (rrethina e Vranjës).
- **NERADOVCI I POSHTËM** (rrethina e Vranjës).
- **NESUSHTA** (rrethi i Jabllanicës).
- **NEVADA** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 26 shtëpi shqiptare.
- **NICA** (Qarku i Toplicës).
- **NISHI** - Nishlitë (Hadri, Bunjaku).
- **NOVOSELLA** (rrethina e Leskocit).
- **NOVOSELLA** (rrethi i Pqinjtit).
- **NOVOSELLA** (rrethina e Lebanës).
- **NOVOSELLA** (rrethina e Prokuplës).
- **NOVOSELLA** (rrethina e Surdulicës).
- **NOVOSELLA** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 10 shtëpi shqiptare.
- **OBËRTINCA** (rrethina e Prokuplës). Vendbanim shqiptarë.
- **OBLLAQINA** (rrethina e Meroshinës).
- **OBRAZHDA** (rrethina e Bojnikut). Kishte 34 shtëpi shqiptare.
- **ORACI** (Qarku i Toplicës).
- **ORANA** (rrethina e Bojnikut, rrethi i Jabllanicës).
- **ORAQA** (rrethi i Kosanicës).
- **ORASHACI** (rrethina e Leskocit).
- **ORLANA** (rrethina e Dolevcit).
- **ORLIŠTA** (rrethi i Kosanicës). Kishte 33 shtëpi shqiptare.
- **ORLLOVCI** (rrethina e Kushumlisë).
- **OSTRAGLLAVA** (rrethina e Vranjës).
- **OTULLA KONJSKA** (rrethi i Pqinjtit).
- **PACA** (rrethi i Prokuplës).
- **PAÇARA** – Paçarët. Jetojnë në Gremnik dhe Drenoc të Klinës.
- **PAÇARADA** (rrethina e Kushumlisë). Kishte 19 shtëpi shqiptare.
- **PARADA** (rrethina e Kushumlisë).
- **PASHINCA** (rrethina e Prokuplës). Kishte 1 shtëpi shqiptare dhe 8 shtëpi serbe.
